



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - * Aktivitetet tjera

Maj 2019

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Interpretimi i legjislacionit tatimor në Kosovë

Më 07-08 Maj 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), organizoi trajnimin e radhës me temë “ Interpretimi i legjislacionit tatimor në Kosovë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në interpretimin e drejtë të legjislacionit tatimor dhe në zbatimin e drejtë të tij në praktikë.

Çështjet të cilat u trajtuan dhe i ‘u kushtua me shumë rëndësi ishin : Ligji mbi të ardhurat e Korporatave, Udhëzimi Administrativ për Transferimin e Çmimeve, dispozitat e Ligjit për tatimin në të Ardhura Personale. Vëmendje të

veçantë gjatë këtij trajnimi kishte edhe Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat e tij, dilemat dhe sfidat që hasen në rastet e ndryshme në praktikën gjyqësore.

Metodologjia e përdorur ishte e kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive, ku trajnuesit përmes rasteve praktike dhe interpretimit të dispozitave ligjore ofruan zgjidhjet e duhura.

Përfitues të këtij trajnimi dy-ditor ishin gjyqtar dhe bashkëpunëtorë profesional nga Gjykatat Themelore dhe Gjykata e Apelit të Republikës së Kosovës.



Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Më 8, 10 dhe 11 maj 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasaden e SHBA-se (Departamenti Ligjor i SHBA-së) ka realizuar trajnimin regional të radhës me temë Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e përfituesve me dispozitat e reja ligjore të Kodit Penal për zbatimin e drejtë të tyre në praktikë.

Gjatë trajnimit për tre ditë me radhë janë trajtuar ndryshimet legislative duke analizuar ndryshimet që kanë të bëjnë me veprat penale kundër shërbimeve komunale, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe nenet e reja që janë përfshirë në Kodin Penal i cili ka hyr në fuqi.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe

ndryshimeve që priten të bëhen në Kodin e Procedurës Penale, siç është mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, hudhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar hudhjen, masat e veçanta hetimore, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë. Po ashtu u diskutua dispozita e re që rregullon suspendimin e personit zyrtar nga detyra, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, gjykimi në mungesë, seanca për caktimin e dënimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar, prokuror, avokat dhe mbrojtës të viktimave nga regjioni i Pejës.



Barazia Gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës

Më 10 maj 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “Barazia Gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me barazinë gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës”

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: Cenimi i pjesës së domosdoshme dhe procedura gjyqësore në rastet e cenimit, mos-deklarimi i trashëgimtarëve dhe procedura pas shpalljes së trashëgimisë, diskriminimi në të drejtën e trashëgimisë në forma tjera si cenimi për së gjalli apo edhe ndarja faktike, diskriminimit në punë dhe mënyra e shfaqjes së diskriminimit mbi baza gjinore. Ndërsa në pjesën e dytë të trajnimit u trajtuan: Mbrojta gjyqësore në rastet e diskriminimit mbi baza gjinore dhe hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore sipas specifikave të procedurës dhe rasteve.

Që në fillim u potencua se e drejta në pjesën e domosdoshme është një e drejtë e një personi fizik që sipas dispozitave të Ligjit për trashëgimi është i thirrur të trashëgoi por që

është në kundërshtim me dëshirën-vullnetin e fundit të trashëgimlënësit me rastin e disponimit të pasurisë së tij pas vdekjes. Përmbajtja dhe lartësia e të drejtës në pjesën e pasurisë së domosdoshme është e përcaktuar me norma të karakterit imperative. Pjesa e domosdoshme nuk përcaktohet sipas detyrës zyrtare, por kjo përcaktohet dhe realizohet vetëm me kërkesën e trashëgimtarit që ka cilësinë e trashëgimtarit të domosdoshëm sipas ligjit.

Në këtë trajnim u potencua se aktvendimi i marrë në procedurën trashëgimore ka efektin deklarativ, dhe personi- trashëgimtar i ligjor ose legatar, nuk ka pengesë që të iniciojë kontestin kundër trashëgimtarit të shpallur si trashëgimtar testamentar apo ligjor për të kërkuar të drejtat nga pasuria trashëgimore, sikundër edhe personi që ka kërkesa materialo- juridike në pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit e ka një të drejtë të tillë për të iniciuar kontestin civil. Trashëgimtarët të cilët nuk janë të përfshira në procedurën e trashëgimisë e kanë të drejtën për të iniciuar kontestin civil me padi trashëgimore, kundër trashëgimtarëve ligjor të përfshirë në procedurën e trashëgimisë dhe kundër të cilëve janë shpallur trashëgimtar.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e barazisë gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës.

Përfituesë ishin gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesioanl në Republikën e Kosovës.

Zbatimi i Ligjit për Azilin në Republikën e Kosovës

Më 13 maj 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e UNHCR-të në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “Zbatimi i Ligjit për Azilin në Republikën e Kosovës”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rolin e akteve ndërkombëtare për azilin dhe legjislacionit në fuqi për azilin me rastin e vendosjes për azilin si dhe roli i palëve në procedurën e azilit që zhvillohet në Republikën e Kosovës.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: E Drejta Ndërkombëtare për Refugjatët - Konventën Ndërkombëtare për Azilin dhe rëndësia e zbatimit të Ligjit për Azilin i Kosovës. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Zbatimi i legjislacionit për azilin në çështjet për azilin - raste nga praktika gjyqësore dhe raste studimore e shembuj nga praktika gjyqësore nacionale dhe e shteteve në rajon lidhur me azilin.

Që në fillim u shpjegua roli i Konventës Ndërkombëtare për Azilin dhe raporti i Ligjit për Azilin i Kosovës me këtë Konventë. Gjithanshëm u trajtua zbatimi i dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën lidhur me kërkesën e azilkërkuësve të ushtruar pranë Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit Kombëtar për Refugjatë të Kosovës si dhe procedura e konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Çështjet në fokus ishin edhe dilemat që ndërlidhen me statusin dhe qëndrimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, procedurën ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të dispozitave të Ligjit për Azilin si dhe zbatimin e drejtë të tyre nga organet kompetente të Republikës së Kosovës.

Në këtë trajnim u potencua se në Republikën e Kosovës, nuk duhet të dëbohet ose kthehet refugjati në asnjë mënyrë në kufijtë e territoreve, ku do të kërcënohet jeta apo liria e azilkërkuësit për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike. Republika e Kosovës, iu njeht të drejtën e azilit shtetasve të huaj apo personit pa shtetësi me kërkesën e tij, i cili plotëson kriteret e refugjatit të përcaktuar me Ligjin për Azilin. Mirëpo, në Republikën e Kosovës, mund të përjashtohet edhe e drejta për azilin ndaj personave për të cilët ka bazë se: ata kanë kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit konform Kartës së OKB-së.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në çështjet e azilit.

Përfituesë ishin gjyqtarët e Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, prokurorë nga Prokuroritë Themelore, bashkpunëtorë profesional në gjykata dhe prokurori, zyrtarë të UNHCR-it dhe shoqërisë civile (CRPK-së).

Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në çështje penale

Me 14 maj 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme dhe në mbështetje nga GIZ, realizoi trajnimin me temë “Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në çështjet Penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje penale duke filluar nga hartimi i kërkesave për ndihmë juridike ashtu edhe trajtimi i tyre kur paraqiten nga shtetet kërkuese si dhe për hartimin e vendimeve në procedurën e ekstradimit.

Gjatë trajnimit është elaboruar baza ligjore dhe përkufizimet e veprimeve të caktuara të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, duke i vënë theks të veçantë ekstradimit, rolit të Ministrisë së Drejtësisë në këtë proces, si dhe mundësive të ndryshme për bashkëpunim me shtetet e ndrysh-

me.

Gjithashtu përmes shembujve nga praktika gjyqësore u shpjeguan aspektet si: ekstradimi, roli i prokurorisë themelore pas pranimit të kërkesës për ekstradim, procedura gjyqësore për ekstradim, procedura e thjeshtësuar e ekstradimit, vendimet e gjykatës lidhur me kërkesën për ekstradim, vendimet e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me të njëjtat, kërkesat konkurruese për ekstradim, transferimi i procedurës penale, transferimi i personave të dënuar, njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve si dhe ndihma juridike e ndërsjellë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga instanca themelore dhe ajo e Apelit, e të gjitha rajoneve të Republikës së Kosovës.



Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit

Më 16 maj 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin dyditor me temë: “Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit” në kuadër të PTV-së.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën e shqyrtimit të propozimit përmbarimor dhe lejimit të përmbarimit si dhe vendimet që merren në fazën e shqyrtimit të prapësimit.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Titujt e përmbarimit-dokumenti përmbarimor dhe dokumenti i besueshëm dhe kushtet për lejimin e përmbarimit. Në pjesën e dytë u trajtuan kompetenca për vendosje lidhur me prapësimin dhe shkaqet për paraqitjen e prapësimit si dhe vendimet e gjykatës lidhur me këtë. Që në fillim u potencua se Ligji i Procedurës Përmbarimore rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaruese dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.

Në vazhdim u theksua se Ligji i Procedurës Përmbarimore parasheh prapësimin si mjet juridik me të cilin palët mund të atakojnë vendimin e organit përmbarues, me të cilin është lejuar përmbarimi. Zbatimi i procedurës së përmbarimit nga ana e përmbaruesve privat ka përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbarimit nga gjyqtarët dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave, që shpesh marrin një pjesë të rëndësishme të kohës së tyre.

U vequa vlerësimi se vonesat e mëdha në përmbarimin e aktgjykimeve civile në gjykatat në Kosovë dëmtojnë rëndë të drejtën për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme duke dëmtuar neëpërgjithësi sundimin e ligjit. Në këtë kontekst Komisioni Evropian në Raportin e progresit për Kosovën për vitin 2010 thekson se: “aktgjykimet e pa ekzekutuara kanë shkelur besimin e publikut, në aftësinë, profesionalizmin dhe korrektësinë e gjyqësorit duke kufizuar në këtë mënyrë qasjen efektive në drejtësi.

Gjithashtu u theksua se sistemi privat i përmbarimit ka gjithashtu përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbarimit nga gjyqtarët dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave. Këto përgjegjësi i kalojnë agjentëve privat, por roli i gjykatave mbetet mjaftë i rëndësishëm sepse çështjet me të ndjeshme si janë çështjet familjare mbesin kompetence ekskluzive të gjykatave, po ashtu mjetet juridike mbesin në vendosje të gjykatave si dhe funksion tjetër i rëndësishëm është mbikëqyrja sepse palët të cilët mendojnë se agjenti privat ka shkelur ndonjë të drejtë të tyre mund të drejtohen gjykatës. Për këto arsye u potencua se sistemet e përmbarimit të bazuar rreth agjentëve privat të përmbarimit janë bërë standarde në pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore dhe në shtete ish socialiste dhe në Evropën Qendrore dhe Evropën Lindore.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit dhe analizës së rasteve studimore, u zbërthyen dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi. Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, bashkëpunëtorët profesional dhe përmbaruesit privat.

Krimet e luftës

Më 16-17 maj 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë ‘Krimet e luftës’.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira të hartojnë si dhe të përfaqësojnë në gjykata krimet sipas të drejtës ndërkombëtare, lidhur me konfliktet e armatosura, dhe vendet e përfshira në luftën lidhur me hetimin dhe analizimin e dëshmitarëve në cilësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Fillimisht nga ana e trajnuesve ndërkombëtar u prezantuan krimet si pjesë e një sulmi të përhapur apo sistematik kundër një popullate civile qëllimi i së cilës është shkatërrimi në tërësi apo pjesërisht të një grupi nacional, etnik, racor apo religjioz siç theksohet edhe me Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollat shtesë.

Në sesionin e parë u elaboruan format kryesore të përgjegjësisë, nxitja, kryerja, bashkëkryerja, veprime të përbashkëta kriminale (VPK), forma

‘sistematike, sistem i organizuar i keqtrajtimit, përgjegjësia komanduese, raporti epror – vartës, si dhe përgjegjësit e eprorit për vartësit e tyre në kryerjen e veprave kriminale gjatë kohës së konfliktit të armatosur

Në sesionin e dytë u elaborua hetimi, grumbullimi i provave kërkimi dhe ndalimi, kërkesat për ndihmë juridike – përfshirë bashkëpunimin me Mekanizmat e Tribunaleve Ndërkombëtare Penale, mbrojtja e burimeve të ndjeshme dhe dëshmitarëve të ndjeshëm, intervistimi i dëshmitarëve, intervistimi i të dyshuarve. si dhe menaxhimi i informatave përfshirë trajtimin, procesimin dhe ruajtjen e dëshmive, analiza e dëshmive si dhe barra e të provuarit, rast rrethor, mjetet për zvogëlimin e rrezikut nga frikësimi i dëshmitarit (përfshirë risitë ligjore të propozuara në Kodin).

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtaret, prokurorët si dhe bashkëpunëtorët profesional nga Departamenti i Krimeve të Rënda të Gjykatave dhe Prokurorive.



Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Më 16, 17 dhe 18 maj 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së (Departamenti Ligjor i SHBA-së) ka realizuar trajnimin me temë Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e përfituesve me dispozitat e reja ligjore të Kodit Penal për zbatimin e drejtë të tyre në praktikë.

Gjatë trajnimit për tre ditë me radhë janë trajtuar ndryshimet legislative duke analizuar ndryshimet që kanë të bëjnë me veprat penale kundër shërbimeve komunale, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe nenet e reja që janë përfshirë në Kodin Penal i cili ka hyr në fuqi.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe ndryshimeve që priten të bëhen në Kodin e

Procedurës Penale, siç është mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, hudhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar hudhjen, masat e veçanta hetimore, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë. Po ashtu u diskutua dispozita e re që rregullon suspendimin e personit zyrtar nga detyra, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, gjykimi në mungesë, seanca për caktimin e dënimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar, prokuror, avokat dhe mbrojtës të viktimave regjioni i Ferizajit.



E drejta për liri dhe siguri - Neni 5 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Më 23 maj 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “E drejta për liri dhe siguri - neni 5 i KEDNJ”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rolin, strukturën, dhe detyrimet pozitive nga neni 5 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ).

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: Përmbajtja e dispozitave dhe nocioneve themelore të nenit 5 të KEDNJ dhe Standardet kryesore në dispozitat e nenit 5 të KEDNJ lidhur me rastin e ndalimit të personit nga ana e shtetit. Në pjesën e dytë të trajnimit u trajtuan: Baza ligjore specifike dhe dispozitat që rregullojnë situatën e të ndaluarit si dhe praktika gjyqësore dhe risitë që sjell ajo lidhur me zbatimin e dispozitave të nenit 5 të KEDNJ.

Që në fillim u zbërthyen kërkesat që përmban neni 5 i KEDNJ - E drejta për liri dhe siguri në kontekst të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Gjithanshëm u trajtuan edhe dilemat në praktikë rreth zbatimit të dispozitave të nenit 5 të KEDNJ-së, në këtë kontekst ligjshmëria e paraburgimit, bazat e lejuara, garancitë procedurale, ndalimi pas dënimit, paraburgimi në pritje të depërtimit dhe e drejta për kompensim.

Në këtë trajnim u potencua se neni 5 i KEDNJ-së përfshin elementet kyçe në mbrojtjen e të

drejtave të njeriut të një individi. Privimi nga këto të drejta ka lidhje dhe efekt të drejtpërdrejtë sa i përket gëzimit të shumë të drejtave të tjera, si e drejta e familjes dhe ajo private, e drejta për lirinë e tubimit, të shprehjes e deri tek e drejta e lirisë së lëvizjes. Gjithashtu në këtë sesion u trajtuan standardet të cilat mbrojnë lirinë fizike dhe veçmas lirinë nga arrestimi dhe ndalimi arbitrar duke u shoqëruar me shembuj nga praktika e GJEDNJ.

Gjithashtu u konkludua se gjyqtarët në mënyrë të vazhdueshme duhet të kenë parasysh se me qëllim që liri të tilla të jenë kuptimplote, çdo privim nga ato duhet të jetë gjithmonë vetëm në rrethana përjashtuese, të jetë i justifikuar në mënyrë objektive dhe të mos zgjasë më shumë sesa të jetë absolutisht e nevojshme.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e të drejtës për liri dhe siguri konform KEDNJ dhe të shoqëruara përmes detyrave të ndara në grupe të pjesëmarrësve .

Përfituesit: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.



Masat edukative dhe dënimet ndaj të miturve

Më 28 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka organizuar trajnimin me temë “Masat edukative dhe dënimet ndaj të miturve”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin në praktikë të masave edukuese të cilat mund ti shqiptohen të miturve.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan ndryshimet me Kodin e ri të Drejtësisë të masat edukative për të mitur, të cilat ofrojnë mundësi për zgjidhjen më të shpejtë të masave edukative, si dhe ndryshimi i vendimit për ekzekutimin e masës edukuese. Po ashtu vëmendje të veçantë

kanë pasur format e vendimeve si dhe ekzekutimi i masave dhe dënimeve.

Më tej, u elaborua ekzekutimi i masave dhe dënimeve tek rastet ku të miturit janë shtetas të huaj si dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar tek rastet ku kryesit e mitur janë shtetas të huaj. Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që i hasin gjatë praktikës gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Masat e fshehta

Më 29 Maj 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), ka realizuar trajnimin me temë “Masat e fshehta”.

Synimi kryesor i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth kornizës ligjore, e cila rregullon mënyrën e lëshimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, dhe procedurën e zbatimit dhe aplikimit të këtyre masave.

Gjatë këtij trajnimi u theksua rëndësia e këtyre masave dhe zbatimi i tyre i drejtë në praktikë, llojet e të gjitha masave dhe fazat e hetimit gjatë të cilave ato mund të autorizohen. Më tej u trajtuan kushtet për lëshimin e këtyre masave, afatet kohore për lëshimin e këtyre masave, të

drejtat e palëve të prekura nga këto masa, mundësitë teknike të mbikëqyrjes së zbatimit teknik-praktik të këtyre masave. Në këtë kontekst u shtjelluan kompetencat e policisë, prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake.

Metodologjia e trajnimit ishte trajtimi i rasteve të studimit nga praktika gjyqësore, një kombinim i teorisë dhe rasteve praktike të parashtruara nga trajnuesit me qëllim të kontributit në unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me këtë fushë.

Përfitues të këtij trajnim ishin: Gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional.



Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Më 30-31maj dhe 1 qershor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-se (Departamenti Ligjor i SHBA-së) ka realizuar trajnimin e radhës me temë: “Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e përfituesve me dispozitat e reja ligjore të Kodit Penal për zbatimin e drejtë të tyre në praktikë.

Me rastin e këtij trajnimi për tre ditë me radhë janë trajtuar ndryshimet legjislative duke analizuar ndryshimet që kanë të bëjnë me veprat penale kundër shërbimeve komunale, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe nenet e reja që janë përfshirë në Kodin Penal i cili ka hyr në fuqi. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe

ndryshimeve që priten të bëhen në Kodin e Procedurës Penale, siç është mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, hudhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar hudhjen, masat e veçanta hetimore, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë. Po ashtu u diskutua dispozita e re që rregullon suspendimin e personit zyrtar nga detyra, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, gjykimi në mungesë, seanca për caktimin e dënimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar, prokuror, avokat dhe mbrojtës të viktimave regjioni i Mitrovices.



Trajnimi praktik i kontratës për kredinë

Më 31 Maj 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), ka realizuar trajnimin me temë “Trajtimi praktik i kontratës për kredinë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave kontraktuese në kontestet që paraqiten në gjykata si dhe rreth kornizës ligjore dhe rregullave të BQK-së, të cilat rregullojnë kontratën për kredinë dhe kamatëvonesën

Gjatë këtij trajnimi u theksua rëndësia e kontratës për kredinë dhe zbatimi i saj i drejtë në praktikë si dhe u trajtuan forma, elementet esenciale të kësaj kontrate, shkëputja e saj, kamatëvonesa si dhe shumë veçori të tjera. Më tej u trajtuan edhe klauzolat e kontratës së

kredisë, kthimi i parakohshëm i kredisë, kamata, hipoteka dhe përmbarimi i saj. Në këtë kontekst u shtjelluan kompetencat e Gjykatës dhe baza ligjore e përmbarimit të hipotekave.

Në këtë trajnim u aplikua metodologjia interaktive e të mësuarit e cila përbëhet prej ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve duke përfshirë trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantimin e rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët, zyrtarët ligjor nga Gjykata e Apelit dhe zyrtarët ligjor nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VI) gjatë muajit Maj 2019

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar.

Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar gjithsejtë 3 sesione trajnuese nga moduli: Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës.

Nga nën moduli: “Procedurat e veçanta sipas KPPK-së janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku janë trajtuar çështjet si: Përgjegjësia penale e personit fizik, Paaftësia mendore dhe paaftësia e zvogëluar mendore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Sëmundjet mendore të përkohshme dhe të përhershme, Paraburgimi për personat me çrregullime mendore, Masat e trajtimit të detyrueshëm, Procedura penale ndaj të miturve me çrregullime mendore etj.

Nga nën moduli: “Procedurat sipas mjeteve

juridike” është realizuar një (1) sesion trajnues dhe është diskutuar për mjetet e rregullta juridike me theks të veçantë për Ankesë, Afatet e ankesës, Të drejtat e të pandehurit për ankesë, Mjetet e jashtëzakonshme juridike, Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, Kërkesa për rishikim të procedurës, Kërkesa për zbutje të denimit etj.

Gjithashtu gjatë muajit Maj 2019, gjyqtarët e sapo emëruar të komunitetit serb i janë nënshtruar edhe testit përfundimtar nga modulet: Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, E drejta civile, administrative dhe ekonomike (pjesa materiale dhe procedurale).

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 2 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur pesë (5) gjyqtarë të komunitetit serb.



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII), ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar.

Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar gjithsejtë 18 sesione trajnuese nga moduli: E drejta civile, administrative dhe ekonomike.

Nga nën moduli: “Procedura Kontestimore – pjesa e dytë janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë diskutuar këto çështje: Sigurimi i kërkespadiës, ndërprerja e procedurës së gjykimit, pushimi i procedurës kontestimore, shpenzimet e procedurës kontestimore, lirimi nga pagimi i shpenzimeve etj.

Gjithashtu nga nën moduli: “E drejta Familjare” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapo emëruar mësuan më shumë rreth kuptimit dhe llojeve të birësimit, themelimit dhe shuarjes së birësimit, kuptimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, pjestimit të pasurisë së përbashkët, masat mbrojtëse kundër dhunës në familje etj.

Nga nën moduli: “E drejta Administrative” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese ku janë trajtuar temat si: Parimet dhe nxjerrja e aktit administrativ, ekzekutimi i vendimit përfundimtar administrativ, konflikti administrativ, palët në procedurën administrative, padia në konfliktin administrativ, mjetet juridike dhe ato të jashtëzakonshme në konfliktin administrativ etj.

Edhe nga nën moduli: “E drejta Ekonomike” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto tema: E drejta ekonomike-tregtare, llojet e shoqërive tregtare, falimentimi, likuidimi dhe riorganizimi i personave juridik, kontratat në ekonomi, punët bankare dhe

sigurorese, të drejtat nga pronësia intelektuale,



markat tregtare, mënyrat alternative të zgjidhjes së kontesteve (Arbitrazhi, Ndërmjetësimi).

Gjithashtu nga nën moduli: “E drejta e Detyrimeve” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku pjesëmarrësit u njoftuan më shumë rreth nocionit dhe klasifikimit të detyrimeve, burimet formale dhe materiale të detyrimeve, parimet e detyrimeve dhe të drejtës kontraktore, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për lidhjen e kontratës etj.

Nga nën moduli: “E drejta e Trashëgimisës janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto çështje: Objekti i trashëgimisës, trashëgimia në bazë të ligjit, radhët e trashëgimisës, të drejtat e trashëgimit jashtëmartsor, pjesa e domosdoshme e trashëgimisës, trashëgimia në bazë të testamentit, ndarja e sendeve të trashëgimisës, ndarja e sendeve të shtëpisë etj.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 12 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar si dhe një (1) vizitë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur (39) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.

Raporti i vizitës së gjyqtarëve të sapo emëruar (Gjenerata VII) në Gjykatën Kushtetuese

Më 27.05.2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve Fillestare, organizoi për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII) vizitë në “Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës”.

Në kuadër të kësaj vizite, gjyqtarët u njoftuan për së afërmi me, ligjshmërinë, punën, veprimtarinë, problemet me të cilat ballafaqohet ky institucion.

Si fillim u diskutua baza rreth historikut të Gjykatës Kushtetuese në Kosovë e cila ka një historik të vjetër, që daton nga viti 1969 kur nën ligjet e KSAK-së u formua edhe dega gjyqësore kushtetuese pranë Gjykatës Supreme në Kosovë.

Pastaj si vazhdimësi e përpjekjeve shumëvjeçare u diskutua edhe për themelimin e Gjykatës Kushtetuese në vitin 2008, për grupin punues dhe anëtarët e parë.

Më pastaj u diskutua baza ligjore e Gjykatës Kushtetuese e cila mbështetet ekskluzivisht në aktin më të lartë juridik të vendit që është Kushtetuta e Republikës së Kosovës e publikuar më 09 Prill 2008, si dhe ligji për Gjykatën Kushtetuese

Gjatë diskutimeve u trajtua edhe roli dhe qëllimi i Gjykatës Kushtetuese e cila është mbrojtja e kushtetutshmërisë, mbrojtja e të drejtave të qytetarëve, kontrollimi i shkeljes së ndonjë dispozite ligjore, efikasiteti i sistemit gjyqësor si dhe parimet mbi të cilat ushtron veprimtarinë gjykata kushtetuese siç janë: Barazia, paanësia, pavarësia dhe profesionalizmi i gjykatës.

Gjithashtu gjatë trajnimit u trajtua edhe zgjedhja e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese, të cilët zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me gjithsejtë 9 anëtarë, 7 prej të cilëve zgjedhën me 2/3 e deputetëve, kurse 2 anëtarët tjerë

zgjedhën me shumicë votash.

Si pjesë e ligjëratisë ishte edhe diskutimi i vendimeve të gjykatës së Strasburgut, raporti i Gjykatës Kushtetuese me atë gjykatë, vendimet e bazuara duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, rekomandimet në vendimmarrje etj.

Më tej u trajtua edhe Komisioni i Venecias, ku Gjykata Kushtetuese e Kosovës është pjesë e atij komisioni dhe deri më tani i ka adresuar 7 lëndë për shqyrtim. Roli i Komisionit është që të ofrojë këshilla ligjore për shtetet anëtare, posaçërisht për të ndihmuar shtetet që dëshirojnë që t'i përshtatin strukturat e tyre legale dhe institucionale në një linjë me standardet evropiane. Gjithashtu Komisioni ofron përvojë ndërkombëtare në sferën e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.

Gjithashtu gjatë trajnimit u shtjelluan edhe çështjet e procedimit të kërkesave pranë gjykatës kushtetuese, forma e vendimmarrjes, neni 113.7 lidhur me kërkesat individuale, neni 113.8 lidhur me kontrollin incidental, efektet juridike të vendimeve të dala nga Gjykata Kushtetuese etj.

Trajnimi u realizua në mënyrë interaktive mes pjesëmarrësve dhe trajnuesve.

Përfitues të trajnimit ishin Gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII) 2019-2020.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Shkathësitë ligjore dhe gjyqësore

Më 30-31 maj 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “Shkathësitë ligjore dhe gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të stafit administrativ lidhur me rolin dhe rëndësinë e shkathësive ligjore dhe gjyqësore.

Në ditën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: parimet dhe shkathësitë e shkrimit ligjor, metoda IRAC e të shkruarit ligjor dhe aplikimi praktik i metodës IRAC. Ndërsa në ditën e dytë të trajnimit u trajtuan: Teknikat e hulumtimit ligjor si dhe procesi e parimet e shkrimit të mirë ligjor.

Që në fillim u shpjeguan dhe zërthyen standardet bashkëkohore të shkrimit dhe arsytimit ligjor. Shkrimi dhe arsytimi ligjor është pjesë e punës së përditshme për secilin zyrtar të gjykatave dhe prokurorive, prandaj është edhe parakusht për ngritje e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera të ndryshme, e rrjedhimisht edhe parakusht për efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në vendimet gjyqësore.

Në këtë trajnim u potencua se shkrimi i mirë ligjor karakterizohet me saktësinë, të ketë bazë solide ligjore, analitik, të mos jetë thjesht deklarim apo rishikim i fakteve dhe opinioneve, i organizuar dhe të ketë rregull në paraqitjen e tij. Po ashtu u kërkua që të mbulojë të gjitha aspektet, specifik dhe konkret, jo me dy kuptime, logjik, të ketë strukturë dhe organizim, korrekt, gramatikë të mirë, shenja pikësimi,

bindës, ta bëjë lexuesin ta besojë shkrimin dhe i qartë, i lehtë për t’u kuptuar.

Gjithashtu u shpjeguan hapat para-shkrimore siq janë: 1. Përcaktimi i qëllimit, Pse nevojitet dokumenti, 2. Përcaktimi i audiences - Kush do ta përdorë dokumentin dhe 3. Përcaktimi i pengesave.

Per metodën ÇRAK (IRAC-anglisht)-(Çështja, Rregulli, Analiza dhe Konkluzioni) u potencua se përbëhet prej elementeve themelore të përmendura të analizës ligjore. Është proces nëpërmjet të cilit të gjithë juristët mendojnë rreth çdo problemi ligjor. Nëpërmjet zbatimit të kësaj formule reduktohet kompleksiteti i ligjit në një ekuacion të thjeshtë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe nga praktika duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e parimeve dhe shkathësive të shkrimit ligjor, metodës ÇRAK (IRAC) të të shkruarit ligjor dhe teknikave të hulumtimit ligjor si dhe përmes detyrave të ndara në grupe për pjesëmarrësit.

Përfituesit: Bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe asistentet-sekretaret juridike.

Aktivitetet tjera

Punëtori për diskutimin dhe hartimin e planeve të monitorimit të punës dhe planit strategjik si dhe kurrikulave trajnuese të Akademisë së Drejtësisë

Nga data 30 prill - 03 maj 2019, Akademia e Drejtësisë ka realizuar punëtorinë me temë: “Diskutimi dhe hartimin i planeve të monitorimit të punës dhe planit strategjik si dhe kurrikulave trajnuese të Akademisë së Drejtësisë”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte hartimi i Planit të monitorimit të Planit të Punës dhe Planit të Strategjik si dhe standardeve të botimit duke përfshirë edhe vlerësimin e nevojave për një program kornizë për Akademinë e Drejtësisë.

Pas analizimit dhe diskutimeve të shumta, grupi punues ka punuar në hartimin e Planit të monitorimit të Planit të Punës për vitin 2019 si dhe të

Planit të monitorimit të Planit Strategjik të AD-së si dhe në Identifikimin e rreziqeve të mundshme me rastin e zbatimit të aktiviteteve sipas planifikimit.

Përveç këtyre dokumenteve grupi punues ka punuar edhe në draftimin e standardeve të punimeve për botime në revistat e Akademisë si dhe ka diskutuar për mundësinë e hartimit të një Programi kornizë të trajnimit (2-3 vjeçar) duke përcaktuar strukturën e këtij programi çfarë duhet të përmbajë.

Pjesëmarrës ishin Drejtori Ekzekutiv i Akademisë, stafi nga Departamenti i Programit dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.



Konferenca përfundimtare e Projektit “Sundimi i ligjit në Evropë, kërkesat dhe sfidat për gjyqësorin evropian

Më 13-14 Maj 2019, Në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në Luxembourg, ka zhvilluar punimet Konferenca Përmblyëse e Projektit “Sundimi i ligjit në Evropë, kërkesat dhe sfidat për gjyqësorin evropian” organizuar nga EJTN (Rrjeti Evropian për Trajnimin Gjyqësor).



Qëllimi i kësaj konference ka qenë përmbledhja e projektit për Sundimin e Ligjit të zbatuar nga EJTN në vitet 2018 dhe 2019, duke u fokusuar në: diskutimin lidhur me zhvillimet e jurisprudencës përkatëse të GJEDNJ-së dhe politikën e KE-së në sundimin e ligjit; shkëmbimin e mendimeve në lidhje me sfidat me të cilat përballen gjyqtarët dhe prokurorët

gjatë mbështetjes së sundimit të ligjit, diskutuar në gjashtë seminarët e projektit; diskutimi i përparësive, zhvillimeve dhe veprimeve të ardhshme që kërkohen nga akterët kryesor si këshillat gjyqësorë, ofruesit e trajnimit gjyqësor, shoqatat dhe rrjetet gjyqësore evropiane, duke përfshirë edhe përshtatshmërinë e Manualit të Praktikuesit të Sundimit të Ligjit të EJTN dhe Udhëzuesit për Trajnimin e Sundimit të Ligjit të EJTN, si punë e ndërmarrë nga Rrjeti Global i Integritetit Gjyqësor i UNODC.

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë përfaqësues të lartë të sundimit të ligjit të shteteve të Bashkimit Evropian e më gjerë, duke përfshirë përfaqësues të këshillave gjyqësor, gjyqtarë, prokurorë, përfaqësues të institucioneve të trajnimit gjyqësor, profesionist të sistemit të drejtësisë, përfaqësues të shoqatave dhe rrjetet gjyqësore evropiane. Ndërsa pjesëmarrës nga Kosova në këtë konferencë ishin z. Valon Kurtaj-Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe z. Skender Çoçaj- Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.



Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Faza II)

Prishtinë, më 15 maj 2019, z. Valon Kurtaj-Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, ka marrë pjesë në takimin e parë të Komitetit Drejtues dhe në lansimin e projektit "Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në



familje (Faza II)", financuar nga Qeveria Norvegjeze dhe Këshilli i Evropës, e i zbatuar nga Këshilli i Evropës.

Në këtë ngjarje janë prezantuar objektivat e projektit dhe fazat e implementimit të këtij projektit.

Gjithashtu, gjatë këtij takimi, nga zbatuesit e projektit u vlerësua lartë bashkëpunimi me institucionet të cilat luajnë rol të rëndësishëm në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje siç janë: Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Dhunës në Familje, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencia për Barazi Gjinore, Akademia e Drejtësisë, Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, shoqëria civile dhe organizata jo-qeveritare.



Seminar në Trier-Gjermani

Nga data 27- 28 maj 2019, në Trier të Gjermanisë është mbajtur seminari për zbatimin e direktivave të Bashkimit Evropian në vendimet e Gjykatave vendore të shteteve anëtare të BE-së.



Qëllimi i këtij seminari ishte zbatimi i drejtë i direktivave të BE-së nga shtete anëtare të BE-

së.

Për dy ditë me radhë janë prezantuar direktivat e BE-së dhe janë elaboruar edhe përmes rasteve të studimit duke integruar edhe pjesëmarrësit në punë grupore për të ofruar zgjidhjet e tyre në zbatimin e direktivave.

Gjatë këtij seminari pjesëmarrësit patën rastin që për dy ditë me radhë të njihen edhe me praktikën e Gjykatave të shteteve anëtarë të BE-së, si dhe Vendimet e Gjykatave Evropiane.

Në këtë seminar nga Kosova ka marrë pjesë Ramush Bardiqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.



Takimi i Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë

Më 28 maj 2019, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Programor të AD-së.



Temë kryesore e diskutimit në këtë takim ishte diskutimi i Raportit të Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve për Trajnues.

Anëtarët e Këshillit Programor shqyrtuan një nga një dosjet e pranuar të secilit aplikues në procesin e përzgjedhjes së Trajnuesve të Përkohshëm në Akademinë e Drejtësisë. Si pjesë e këtij takimi dhe shqyrtimit të raportit të Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve për Trajnues, Këshilli Programor unanimisht u pajtua që ti drejtohet me një mendim Këshillit Drejtues të Akademisë lidhur me aplikacionet e parashtruara për trajnues.

Gjatë këtij takimi, anëtarët e Këshillit Programor diskutuan edhe për mundësinë e hartimit të një Programi Kornizë të Trajnimeve në të ardhmen, por pa lënë anash në diskutim edhe tema të tjera të rëndësishme për Akademinë e Drejtësisë e të cilat bien në kompetencën e Këshillit Drejtues.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, më 31 maj 2019, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i gjashtëmbëdhjetë me radhë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Këshilli Drejtues në këtë takim miratoi Programin e Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapoemëruar dhe kërkesën e Këshillit Prokurorial të Kosovës për fillimin e Trajnimit Fillestar për 12 prokurorët e ri të cilët janë dekretuar dhe miratoi emërimin e mentorëve në

trajnimin praktik për këta prokurorë.

Gjatë këtij takimi Këshilli Drejtues formoi Redaksinë e Publikimeve të Akademisë së Drejtësisë dhe miratoi standardet e publikimeve. Më tej, Këshilli Drejtues diskutoi edhe për organizimin e trajnimeve me mbështetjen e donatorëve.

Në këtë takim Këshilli Drejtues, sipas agjendës, diskutoi dhe mori edhe disa vendime tjera me rëndësi për punën e Akademisë së Drejtësisë.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**